



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:069419

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02430680

C.nr.655/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve K.M., L.Q., N.Ç., Q.B. dhe F.Z., që të gjithë me banim në Shtime, të cilët i përfaqëson me autorizim av.Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim LulzimMuharremi nga Shtimja, për çështjen juridike kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, në seancën e mbajtur me datë 2 nëntor 2021 mori këtë :

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve K.M., L.Q., N.Ç., Q.B. dhe F.Z, të gjithë me banim në Shtime, si e bazuar.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Shtimës Drejtoria e Arsimit, që paditësve secilit veç e veç dhe atë:

-Paditëses K.M. nga Shtimja, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 370.30 euro, dhe atë në emër kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Godac i Poshtëm- Shtime dhe anasjelltas, për 70% të biletës së trafikut urban, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri më 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 529 ditë pune.

-Paditëses L.Q. nga Shtimja, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 275.10 euro, dhe atë në emër kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Rashincë- Shtime dhe anasjelltas, për 70% të biletës së trafikut urban, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri më 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 393 ditë pune.

-Padiësit N.Ç. nga Shtimja, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 371.70 euro, dhe atë në emër kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Belincë- Shtime dhe anasjelltas, për 70% të biletës së trafikut urban, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri më 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 551 ditë pune.

-Padiësit Q.B. nga Shtimja, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 373,10 euro, dhe atë në emër kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Raçak- Shtime dhe anasjelltas, për 70% të biletës së trafikut urban, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri më 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 533 ditë pune.

-Padiësës F.Z. nga Shtimja, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 375.20 euro, dhe atë në emër kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Davidoc- Shtime dhe anasjelltas, për 70% të biletës së trafikut urban, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri më 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 536 ditë pune.

III.DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit t'ua paguaj padiësve secilit veç e veç me kamat ligjore prej 8% nga data 15.04.2021 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 747.60€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Padiësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi në gjykate me datë 15.04.2021 dhe në seance i autorizuari i tyre ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet baza juridike e saj si dhe lartësia e saj, me çka i propozon gjykatës që kërkesë padinë e padiësve ta aprovoj si të bazuar. Për padiësit nuk është relevante kundërshtimi dhe përgjigja në padi, sa i përket aktgjykimeve të përmendura në përgjigje në padi se nuk është kërkuar shpenzimi për udhëtim por vetëm shujta ditore dhe shpërblimi jubilar.

Përfaqësuesi i të paditurës Lulzim Maharremi në seancën përgatitorë të dt.02.11.2021 ka deklaruar se mbetet edhe më tutje pranë përgjigjes në padi, duke shtuar se padiësit kanë

parashtruar padi kërkesë padi edhe më herët në gjykatë. konsideron se kjo duhet të merret si çështje e gjykuar për arsyeje se të njëjtit kanë pas të caktuar seanca dhe kanë mundur që ti paraqesin të gjitha kërkesat e tyre në këto seanca dhe jo ti paraqesin në seanca të veçanta pasi kjo është në kundërshtim me parimin e ekonomizimit dhe e tëra shkon në dëm të buxhetit të shtetit, kështu që i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësve ta hudh poshtë si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: certifikata e vendbanimit për secilin paditës, kontrata e punës për secilin paditës, vërtetimi mbi ditët pranisë në punë nr.142/3 datë 03.06.2021 dhe kuponi fiskal, vërtetimi mbi ditët pranisë në punë nr.139/3 datë 03.07.2021 dhe kuponi fiskal, vërtetimi mbi ditët pranisë në punë nr.141/3 datë 03.07.2021 dhe kuponi fiskal, vërtetimi mbi ditët pranisë në punë nr.1083-1 datë 07.07.2021 dhe kuponi fiskal, vërtetimi mbi ditët pranisë në punë nr.110/1 datë 15.07.2021 dhe kuponi fiskal, përgjigja në padi datë 27.05.2021.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjygjëse se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara për secilin veç e veç, nuk ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadiisë por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadiisë se a u takojnë paditësve shumat e kërkuara.

Gjykata përmes kontratave të punës të cilat janë administruara ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, fakt të cilin nuk e kanë kundërshtuar as pala e paditur.

Gjykata me leximin e vërtetimeve mbi ditët e pranisë në punë lëshuar nga Drejtoria e Shkollës Filllore të Mesme të ulet "... ” Shtime, ka vërtetuar faktin e ditëve të pranisë të paditësve në vendin e punës nga data 18.04.2017, kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, dhe atë paditësja Kimete Mustafa për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 529 ditë, paditësja L.Q. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 393 ditë, paditësi N.Ç. për

këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 531 ditë, paditësi Q.B. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 533 ditë, dhe paditësja F.Z. këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 536 ditë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësit e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, kanë qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tyre në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes listës –tabelës të ditëve të punës të lëshuar nga Drejtoria e Shkollës Fillore të Mesme të ulet “ ...” Shtime ndaj sipas 35 par.5 i kontratës kolektive e cila dispozitë ligjore e ka rregulluar se punonjësit e arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhet shpenzimet e rrugës 70%, të biletës urbane.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve secilit veç e veç tua paguaj shumat e specifikuara në pikën II të dispozitivit, në njërën anë kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim të specifikuara për secilin paditës veç e veç sikurse në pikën II të dispozitivit.

Sa i përket lartësisë gjykata këtë fakt e ka vërtetuar përmes çmimorës të lëshuar nga “...” sh.p.k, e datës 21.05.2020, ku një biletë një drejtimshme është 70 cent e cila nuk ka qenë kontestuese as nga e paditura, andaj në rastin konkretë gjykata e ka llogaritur ditët e pranisë në punë, në njërën anë dhe 70% të biletës në ditë në anën tjetër dhe ia ka aprovuar lartësinë secilit paditës sa i përket udhëtimit, nga vendbanimi i tyre deri në vendin e punës.

Sa i pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të

gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 747.60 € dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 312 €, për taksën gjyqësore për padi 30€, dhe për përfaqësim të avokatit në një seancë 405.60€, për shkak se kemi të bëjmë me 5 paditës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.655/21 datë 04 nëntor 2021

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.